

**URDHËR**  
**Nr. 53, datë 4.2.2021**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË DEKLARATËS SË  
EKSPERTIT PËR MARRJEN DIJENI PËR PËRGJEGJËSINË PENALE  
NE RAST EKSPERTIMI TË RREMË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 28, pika 3, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së deklaratës së ekspertit për marrjen dijeni të përgjegjësive penale, në rast ekspertimi të rremë, sipas aneksit bashkëlidhur këtij urdhri, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Falimentimit për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I DREJTËSISË**  
**Etilda Gjonaj (Saliu)**

**ANEKS**

**DEKLARATË**

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, ekspert/e në fushën e \_\_\_\_\_,  
(emër, atësi, mbiemër)

i/e caktuar nga gjykata e falimentimit, sipas përcaktimeve të nenit 28, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë marrjen dijeni për ngarkimin me përgjegjësi penale për kryerjen e një ekspertimi të rremë, sipas parashikimeve të nenit 309, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nëpërmjet kësaj deklarate betohem se do të kryej mirë e me nder detyrat që më janë besuar, me të vetmin qëllim që t'i bëj të ditur të vërtetën gjykatës së falimentimit.

DEKLARUESI

Datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_

---

(emër, atësi, firmë, vulë)